

MBROJTËSI

Vëllimi IV - Nr. 1 ... drejtësi për të gjithë



**BASHKËPUNIMI
ÇELËSI I SUKSESIT
TË SHPK-së**



**ZERO TOLERANCË
NDAJ KRIMIT**





Portat e reja të komunikimit

Në prag të përfundimit të një procesi shumëvjeçar dhe ndërkombëtar për Kosovën, si gjithherë por tani me një qasje tjetër, policia është duke shikuar që të gjejë mënyra sa më të mira të komunikimit me qytetarë. Për shkak të angazhimeve të fundit që po ndodhin në Kosovë, si në sferën politike ashtu edhe në atë të sigurisë, Zyra për informim publik e SHPK-së në bashkëpunim edhe zyrtarë tjerë për informim nga Qeveria dhe UNMIK-u janë dakorduar që mënyra më e mirë e luftimit të dezinformatave dhe thashethemeve të ndryshme është që ato “të mbyten” me informata zyrtare. Nga kjo lindi edhe ideja e prononcimeve të përbashkëta të policisë dhe të pushtetit lokal nëpër radiot dhe TV-të lokale. “Kjo është një “portë” e re e cila është hapur për ngritjen e nivelit të bashkëpunimit në mes policisë dhe pushtetit lokal, por pika më e rëndësishme qëndron tek komunikimi i drejtpërdrejt me qytetarë në këto emisione të organizuara në debate në radio dhe televizione lokale anembanë Kosovës. Zyrtarët policor janë të mendimit që kjo portë të qëndroj gjithmonë e hapur për një komunikim të mirëfilltë me qytetarë.

Në këto takime është adresuar mesazhi se nëse do të festohet pas zgjedhjes së statusit politik të Kosovës atëherë kjo të bëhet në mënyrën e duhur, por edhe nëse ka vend për pakënaqësi edhe kjo të bëhet në suaza ligjore dhe të mos del jashtë kontrollit.

Zyra për informim publik e SHPK-së ka përgatitur edhe një manual të komunikimit për situata të ndryshme që mund të ndodhin gjatë kësaj periudhe kohore. Me këtë manual është paraparë që menaxhimi i situatave të ndryshme sa i përket komunikimit me mediat vendore dhe ndërkombëtare të bëhet në mënyrë sa më fleksibile dhe që nëpërmes informatave të sakta dhe të shpejta të depërtojme tek popullata me informata të konfirmuara zyrtarisht.

Të gjitha këto angazhime janë shtjelluar në temën kryesore të këtij numri “Bashkëpunimi-çelësi i suksesit të SHPK-së”.

Në vend të profilit të oficerit, në këtë edicion do të lexoni intervistën me ministrin e punëve të brendshme – Zenun Pajazitin. Në këtë intervistë ai ceku prioritetet e MPB-së dhe angazhimet e tyre për sundimin e ligjit, për mirëqenien e oficerëve të SHPK-së dhe për planet që kanë të bëjnë me integrimet evropiane dhe me detyrat që dalin nga plani i partneritetit evropian.

Në shkrimin “Plani Strategjik 2008-2010”, do të mund të lexoni në vija të trasha për këtë dokument të rëndësishëm për policinë vendore e që është edhe plani i parë strategjik për SHPK-në.

Ky plan është një dokument dinamik, i cili paraqet vizionin e Policisë si organizatë në përgjithësi si dhe vizionin e përbashkët të të gjitha shtyllave të SHPK-së, në zbatimin dhe respektimin e ligjeve të mbështetura në parimet e demokracisë, profesionalizmit dhe transparencës së punës.

Trajnimet e përbashkëta me MSU-në e KFOR-it dhe të Njësitit Mbështetës Operativ janë trajtuar në temën “Me ushtrime të përbashkëta drejt profesionalizimit”. Qëllimi i këtyre trajnimeve të përbashkëta është ngritja e cilësisë profesionale të NJMN-ve të SHPK-së duke rritur shkallën e kapaciteteve dhe duke ngritur imazhin e policisë në përgjithësi.

Natyrisht se kjo nuk është e tëra, me këtë edicion të Mbrojtësit ju mund të informoheni edhe për sfidat e njësitit të auto-krimeve të rajonit të Gjilanit, ose për problemet lidhur me objektet policore në rajonin e Mitrovicës.

Angazhimet tona të përbashkëta do të vazhdojnë në mënyrë që të kemi një menaxhim sa më të mirë të situatës gjatë periudhës së zgjedhjes së statusit politik për Kosovën, krahas kësaj së bashku do të vazhdojmë edhe rrugën drejt krijimit të një partneriteti me strukturat e BE-së drejt integritetit të strukturat ndërkombëtare të sigurisë.

Të gjitha këto do ti arrijmë me një bashkëpunim të fortë dhe të qëndrueshëm me qytetarët kosovar të cilët janë edhe shtylla e suksesit dhe të të arriturave të SHPK-së.



Buletini informativ i policisë në Kosovë është botim i SHPK-së dhe policisë së UNMIK-ut.

Botues

Njësi i Redaksisë,
Zyra e Komisarit për Media,
SHP i Policisë, Prishtinë

Redaktor

ARBËR BEKA
VSAT: 2699

Tel.: 038 5080 1237
Mob.: 044 146 696

arber.beka@kosovopolic.com
arberbeka@gmail.com
revistambrojtesi@gmail.com

Fotograf

HAKAN UGURLU
www.pbase.com/hugurlu


SERHAT ALLKAN
VSAT: 2323
Mob.: 044 416 106

Disajner

ÇA JUP KAJTAZI
VSAT: 1046
Mob.: 044 315 985
cajup.kajtazi@kosovopolic.com

Asistentët e Redaktorit

DRIN GJONBALAJ
RENATA MARIJANAC



INTERVISTË ME MINISTRIN PAJAZITI

2 ZERO TOLERANCË NDAJ KRIMIT

5 JU DHE LIGJI

Zyrtarët Ligjor të SHPK-së dhe procedurat gjyqësore

6 MIRËNJOHJE PËR TË DALLUARIT

Shpk-ja shpërblen të dalluarit

7 ME KOMPETENCA VJEN PËRGJEGJËSIA

Përurohet tranzicioni i njësitit K-9 dhe NJMO-së

8 MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME PRITI KREUN E SHËRBIMIT POLICOR TË KOSOVËS

9 ATA NUK HARROHEN KURRË FAQE

Dhurata për fëmijet e oficerëve të rënë në linjë të detyrës

10 PLANI STRATEGJIK 2008-2010

SHPK-ja me plan për vizionin e policisë

Tema Kryesore

12 BASHKËPUNIMI-ÇELËSI I SUKSESIT TË SHPK-SË

Lajmet nga rajonet

16 SEKTORI I AUTO-KRIMEVE NË GJILAN

Sfidat dhe sukseset

18 SHPK VAZHDON TRAJNIMET ME MSU-NË ITALIANE

Me ushtrime të përbashkëta drejt aftësimit dhe ngritjes së profesionalizmit

21 KUR DO TË KENË OBJEKTET E TYRE?

Regjioni i Mitrovicës në pritje të realizimit të objekteve policore

24 NDODH EDHE KJO !!!

Foto lajme

25 Përzgjedhje e aktiviteteve

26 Loja shpërblyese

PIKË SHITESË :

Mendimet, komentet, këndvështrimet e shprehura ose të përfshira në përmbajtje të këtij botimi nuk paraqesin medeomos politikat ose vështrimet zyrtare të UNMIK-ut dhe SHPK-së.

ZERO TOLERANCË NDAJ KRIMIT

Në këtë numër të radhës të revistës Mbrojtësi në vend të profilit të oficerit do të mund të lexoni intervistën me Ministrin e Punëve të Brendshme – Zenun Pajaziti. Ai në këtë intervistë foli për aktivitetet e ngjeshura të MPB-së si dhe disa nga prioritetet dhe angazhimeve të planifikuara për këtë vit dhe vitet në vijim. Përveç këtyre Ministri Pajaziti ceku edhe angazhimet e MPB-së për sundimin e ligjit, për mirëqenien e oficerëve të SHPK-së dhe për planet që kanë të bëjnë me integrimet evropiane dhe me detyrat që dalin nga plani i partneritetit evropian.

Intervistë me Ministrin e Punëve të Brendshme – Zenun Pajaziti

Z. Pajaziti, cilat janë disa nga prioritetet e MPB-së për këtë vit?

Ministri Pajaziti: Së pari do të sigurojmë kontinuitetet të aktiviteteve që janë paraparë më herët, dhe ne të njëjtën kohë do të sigurohemi që të dinamizojmë punën dhe të adresojmë edhe çështje tjera me rëndësi vitale për të siguruar sundimin e ligjit. Ky është një momentum i ri dhe ne do të mundohemi të shfrytëzojmë atë maksimalisht. Prioritet do të jetë ruajtja e rendit dhe sigurisë gjatë kësaj faze finale të definimit të statusit final përkatësisht shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Rëndësi e veçantë do t'i kush-tohet kompletimit të infrastrukturës së nevojshme ligjore, ndërmarrjen e reformave gjithëpërfshirëse në sektorin e rendit dhe të sigurisë, ngritjes së kapaciteteve humane brenda Ministrisë dhe SHPK-së, intensifikimit të bashkëpunimit me institucionet tjera relevante vendore dhe ndërkombëtare për të siguruar funksionimin e tërë mekanizmit të nevojshëm për sundimin e ligjit etj. Një fakt me rëndësi është instalimi i misionit të BE-së në fushën e sundimit të ligjit në Kosovë. Në këtë kontekst, Qeveria e Kosovës e mirëpret këtë vendim të BE-së, dhe do të sigurohemi që maksimalisht përfitojmë nga ekspertiza që do të na ofrohet.

Pra, sundimi i ligjit është themeli i prioritetëve dhe aktivitetëve tona e në kuadër të sundimit të ligjit hyjnë një varg aktivitetesh që kanë të bëjnë me luftimin e krimit, korrupsionit etj. Ne do të përqijemi që me të gjitha kapacitetet tona që ne i kemi gjegjësisht me mekanizmat që ekzistojnë në kuadër të kësaj ministrie e me theks të veçantë me SHPK-në do të përqijemi që të jemi në nivel të lartë të detyrës që të mbrojmë sundimin e ligjit. Ne jemi të vetëdijshëm që për të arritur një objektivë të tillë e që është kryesorja, nevojitet një angazhim i koordinuar në veçanti me Ministrinë e

Drejtësisë dhe mekanizma të tjerë relevant mirëpo në dëshirojmë që të luajmë një rol më të madh e pse jo edhe udhëheqës në aktivitetet që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit.

Një çështje tjetër me rëndësi për ne është përkushtimi jonë që fuqishëm të zbatojmë politikën për Zero tolerance ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe se nuk do të bëjmë kompromis me askënd për të siguruar një shoqëri ku sundon rendi dhe ligji.

Cilat janë disa nga aktivitetet që ndërlihen me këtë përkushtim?

Ministri Pajaziti: Numër një këto ditë do të jetë ligji për policinë. E kemi bërë gati dhe do jetë ne pako me ligje tjera që lidhen me pakon e Ahtisarit. Ky ligj do të na ndihmoj shumë për ta avancuar organizimin e policisë si mekanizëm kyç në çështjet që i përmenda më lartë.

Ne kemi marrë besimin dhe përgjegjësinë nga qytetarët e Kosovës që të luftojmë efektivisht krimin e organizuar dhe korrupsionin. Do të marrim masa që veprat korruptive të jenë përjashtim dhe jo rregull në institucionet dhe shoqërinë kosovare. Në luftën kundër korrupsionit do të jemi të pa-kompromis dhe nuk do të lejojmë që veprat korruptive të shndërrohen në norma dhe praktika.

Ne do të kërkojmë ti koordinojmë aktivitetet së pari ato të brendshmet në kuadër të mekanizmave të brendshëm që ne i kemi në MPB, si dhe me të tjerët në mënyrë që të jenë më të konsoliduar për ta luftuar krimin dhe në kuadër të kësaj do të përqijemi që asnjë strukturë dhe asnjë individ të mos jetë mbi ligjin. Unë personalisht por edhe me qëndrimin e Qeverisë dhe Kryeministrit do të jemi vazhdimisht të përkushtuar në drejtim të krijimit të kushteve dhe mundësive për njerëzit që janë të thirrur në përgjegjësi për ta luftuar krimin të jenë në nivel të detyrës dhe ne do ti mbështesim të gjitha aktivitetet dhe

do të mundohemi që tu japim përparësi aktivitetëve që kanë të bëjnë me luftimin e krimit.

Jemi të vetëdijshëm se për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar nevojitet vullnet politik. Pra ne kemi vullnetin, përkushtimin por edhe instrumentet e nevojshme për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Përfundimisht roli dhe participimi i qytetarëve në këtë proces është jetik që pashmangshëm dërgon në arritjen e qëllimeve të përbashkëta.

Cili është mendimi juaj për të arriturat dhe performancën e SHPK-së?

Ministri Pajaziti: Ngritja e performancës së SHPK bëhet duke investuar në ngritjen e kapaciteteve administrative dhe duke trajnuar/specializuar tutje dhe në vazhdimësi pjesëtarët e SHPK-së. Paralelisht me ngritjen dhe avancimin e kapaciteteve humane brenda SHPK-së, do të angazhohem në përmirësimin e kushteve të punës dhe ruajtjen e dinjitetit të pjesëtarëve të SHPK-së. Prioritet i Qeverisë së Kosovës do të jetë rritja e pagave për kategori të caktuara të shoqërisë me rëndësi vitale për funksionimin e shtetit të Kosovës. Në këtë kategori padyshim bëjnë pjesë edhe pjesëtarët e SHPK-së.

Personalisht jam shumë i kënaqur me atë se çfarë ka arritur në tërësi SHPK-ja. E di se ky progres nuk ka mundur të arrihet po të mos kishim një përkushtim të madh të brendshëm të oficerëve që janë angazhuar në këtë institucion e sidomos nga një mbështetje e fuqishme nga partnerët ndërkombëtar për ta avancuar sa më shumë SHPK-në. Por nuk ka vend për vetëkënaqësi ngase periudha në të cilën po hyjmë do të kërkojë më shumë përkushtim, më shumë sakrifica. Ne duhet të përqijemi që oficerët tanë përveç asaj që duhet të duken mirë siç edhe po duken tani, të vazhdojnë të jenë edhe më të dashur për qytetarët dhe më të pranuar për ta, në mënyrë që misioni i tyre i shenjtë të jetë sa më i realizueshëm duke i ngritur kapacitetet e tyre dhe duke i përmirësuar performancën vazhdimisht.



Një prej temave që diskutohen shpesh në mesin e oficerëve të SHPK-së është edhe çështja e mirëqenies së tyre. A pritet të ketë ndonjë lëvizje pozitive në këtë drejtim?

Ministri Pajaziti: Që nga ditët e para të punës sime këtu më janë adresuar vështirësitë me të cilat ballafaqohet në tërësi SHPK-ja, por edhe pa qenë këtu, ne të gjithë kemi qenë të njoftuar gjendjen reale dhe motivimin ekzistues të pjesëtarëve të SHPK-së. Ne nuk mund të jemi të kënaqur me këtë mënyrë të motivimit të tyre dhe jam i sigurt që ka vështirësi serioze që mund të definojnë tash. Unë personalisht jam shumë i përkushtuar dhe shumë i dedikuar të punoj në ngritjen e mirëqenies për oficerët e SHPK-së. Ne do të punojmë vazhdimisht që të arsyetojmë nevojën e madhe që kanë pjesëtarët e SHPK-së që të jenë materialisht më të motivuar. Tani e di se kemi një numër të policëve të cilët kanë nevojë për ndihmë shëndetë-

sore, kemi një numër të oficerëve që kanë rënë në detyrë dhe ne ende nuk kemi një mundësi të mirë për të ndihmuar familjet e tyre. Por ju them se, jo vetëm që janë adresuar këto çështje tek unë, por edhe se janë çështje të cilat do ti theksoj me prioritet gjatë mandatit tim. Edhe çështjet e statusit të tyre, edhe çështjet që kanë të bëjnë me stimulimin financiar por sigurisht, edhe për krijimin e kushteve për sigurime shëndetësore dhe trajtimin më të mirë të familjeve të atyre që kanë rënë në detyrë ose kanë pësuar lëndime të rënda në kryerje të detyrës zyrtare.

Në fund cili do të ishte mesazhi i Ministrit të Punëve të Brendshme për të gjithë oficerët e SHPK-së?

Ministri Pajaziti: Kam kënaqësinë t'i përhëndes dhe t'i përgëzoj të gjithë për punën e madhe që po e bëjnë. SHPK-ja ka rezultate shume te mira dhe mund te them lirshëm se Qeveria

e Kosovës mburret me punën e SHPK-se, unë jam i sigurt se edhe shoqëria Kosovare e ndan këtë bindje.

Tani është shumë e rëndësishme që të mos lejojmë që dikush të na imponojë ndonjë situatë krize apo dhune. Jam i sigurt se me të gjitha këto vështirësi që i kanë ata me përkushtim të madh dhe të pasqorë kryejnë detyrat e tyre në këtë situatë. Po afrohet një ditë që e kemi pritur gjatë, kjo është prituri me dekada të tëra e nga gjenerata të tëra. Dhe çdo qytetar i Kosovës ka hise në këtë proces dhe është meritë për atë që po arrijmë në.

Për fund më lejoni t'i sigurojë të gjithë oficerët e SHPK-së se si Ministër i Punëve të Brendshme do të jam zëri i tyre mbështetës në Institucionet e Kosovës. Ne do të sigurohemi që përmes Ligjit për Policinë të përmirësojmë kushtet e punës në përgjithësi dhe ruajtjen e dinjitetit të pjesëtarëve të SHPK-së, përmes ngritjes së pagave dhe sigurimit shëndetësor dhe pensional, për pjesëtarët e SHPK-së.

ZYRTARËT LIGJORTË SHPK-së DHE PROCEDURAT GJYQËSORE

Gjatë viteve të kaluara ka pasur një numër të konsiderueshëm të kërkesave nga Stacionet Policore si dhe Komandat Regionale Policore të SHPK-së, por edhe kërkesa individuale të pjesëtarëve të SHPK-së për mbrojtje gjyqësore në gjykata nga ana e Zyrtarëve Ligjor në rastet kur akuzohen nga ana e Prokurorëve Publik apo Padi private për vepra të ndryshme penale kundër pjesëtarëve të caktuar të SHPK-së si dhe Padi në kontestet civile (kompensim i dëmit, etj.). Në shumicën e rasteve këto akuza kanë të bëjnë me veprimet e pjesëtarëve të SHPK-së gjatë kryerjes së detyrës zyrtare.

Përkundër asaj që në çdo rast janë dhënë sqarime, duke interpretuar dispozitat përkatëse ligjore, lidhur me këtë e kemi parë të arsyeshme që të japim edhe këtë sqarim për të gjithë pjesëtarët e SHPK-së lidhur me atë që u theksua më lartë me qëllim të kuptimit më të lehtë se në cilat raste mund të ofrohet mbrojtje gjyqësore.

Zyra Ligjore e SHPK-së deri tani është angazhuar aktivisht në ofrimin e ndihmës juridike, dhënien e këshillave juridike, interpretimin e dispozitave ligjore për çka do të jetë e gatshme

edhe në të ardhmen që të realizoj këtë obligim por duke pasur çdo herë parasysh respektimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore të cilat e rregullojnë çështjen e caktuar.

Zyrtarët Ligjor të SHPK-së përveç obligimeve tjera, bëjnë edhe përfaqësimin e SHPK-së në të gjitha procedurat gjyqësore ku si palë në procedurë është SHPK-ja në cilësinë e paditësit, të paditurit apo si palë e dëmtuar, kurse në procedurën penale të cilat zhvillohen sipas padive (akuzave) të ushtruara ndaj pjesëtarëve të caktuar të SHPK-së, Zyrtarët Ligjor të SHPK-së nuk mund të marrin pjesë në procedurë gjyqësore në cilësinë e mbrojtësit (avokatit).

Kjo çështje është e rregulluar me dispozitat e nenit 70 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, me të cilën është përcaktuar: "Për mbrojtës mund të angazhohet vetëm avokati i cili është anëtar i Odës së Avokatëve".

Përkundër kësaj Zyrtarët Ligjor janë angazhuar aktivisht në ofrimin e ndihmës juridike pjesëtarëve të akuzuar të SHPK-së duke i këshilluar të njëjtit mbi të drejtat e tyre për angazhim të mbrojtësit sipas dispozitave të nenit 70, 73 dhe

74 të KPPPK si dhe duke i këshilluar të njëjtit jashtë seancave gjyqësore për mënyrën më të mirë të mbrojtjes nëse nuk është angazhuar ndonjë mbrojtës sipas dispozitave të përmendura më lartë.

Mbrojtja gjyqësore në kontestet civile është e rregulluar me dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore Gaz.Zyrt. nr.4/1977. ku po ashtu është përcaktuar që përfaqësimi për personat juridik mund të bëhet nga personat fizik, çka do të thotë jo edhe për personat fizik ndaj të cilëve ushtrohen Kërkesë padi.

Sidoqoftë në të gjitha rastet e ushtrimit të padive (akuzave) ndaj SHPK-së, apo pjesëtarëve të SHPK-së, ju rekomandojmë që të kontaktoni Zyrën Ligjore për sqarimin e rastit konkret, ngase në raste të caktuara bëhen lëshime-gabime në shkresa të ndryshme edhe nga ana e palëve që marrin pjesë në procedurë gjyqësore (avokat, prokuror, gjykatë, etj.). Tani është duke u shikuar mundësia ligjore që në të ardhmen SHPK-ja të ketë avokatin e vet, për mbrojtjen e pjesëtarëve të saj pranë gjykatave në Kosovë. Numrat kontaktues të Zyrës Ligjore, janë këta: 1086, 1051, 1053 dhe 1054."





MIRËNJOHJE PËR TË DALLUARIT

Në fund të vitit, Komanda Kryesore e Policisë, dha mirënjohje për policët e ShPK-së, të të gjitha regjioneve për rezultatet e treguara gjatë vitit 2007.

Policët të cilët u nderuan me mirënjohje, kanë treguar vërtet rezultate të mira gjatë tërë vitit për punën e tyre të shkëlqyer për profesionalizëm dhe për të arriturat në parandalimin e krimit dhe në bashkëpunimin e mirë me qytetarët.

Këta policë për punë të mirë u propozuan nga komandantët e tyre rajonal.

Mirënjohje nga regjioni i Mitrovicës mori oficeri Idriz Idrizi,

Nga rajoni i Pejës - Sadik Neziri,

Nga rajoni i Gjilanit - Muhamet Sadiku

Nga rajoni i Prishtinës - Makfire Xhemajli

Nga rajoni i Ferizajt - rreshter. Selatin Shahini,

Nga rajoni i Prizrenit - Shpend Morina,
Nga Komanda Kryesore e policisë me mirënjohje u shpërblye togeri Besart Shaqiri dhe nga njësitë e specializuara Sali Ferizi.

Gjithashtu një mirënjohje ju nda edhe policit ndërkombëtar Michael Janson, për ndihmën dhe kontributin e tij dhënë ShPK-së.

Këto mirënjohje u shpërndanë nga Gjeneral major Reshat Maliqi i cili me këtë rast i lavdëroi policët e ShPK-së për punën e tyre të treguar gjatë këtij viti që po e lëmë pas duke mos e haruar punën dhe kontributin e dhënë të të gjithë pjesëtarëve të tjerë të ShPK-së.

"Gjatë vitit që e lamë pas, si shërbim në u ballafaquam me sfida të llojllo-

jshme dhe policët të cilët u shpërblyen janë ata të cilët me punën dhe përkushtimin e tyre profesional në zgjidhjen e rasteve të ndryshme bënë atë që i dallon nga policët e tjerë. Viti para nesh – 2008, do të jetë edhe më sfidues për të gjithë ne si dhe qytetarët. Kam besim të plotë në të gjithë pjesëtarët e ShPK-së, në përvojat e gjertanishme dhe zgjedhjeve të problemeve të cilat do ta dëshmojnë në vazhdimësi përkushtimin tonë në menaxhimin e situatave të ndryshme në aspektin e sigurisë në Kosovë."- theksoi ndër të tjera Maliqi.

Ai i inkurajoi të gjithë policët e SHPK-së që të vazhdojnë edhe më tutje të punojnë për interesat e qytetarëve dhe çdo herë të jenë në shërbimin e tyre me punën dhe profesionalizmin e treguar.



ME REZULTATET E TREGUARA MERREN KOMPETENCAT, ME KOMPETENCA VJEN PËRGJEGJËSIA

Përurohet tranzicioni i njësimit K-9 dhe NJMO-së

Në një ceremoni festive u përu-
rua tranzicioni i dy njësive të
specializuara të SHPK-së: njësi-
tit K-9 dhe NJMO-së (Njësitit
Mbështetës Operativ) të SHPK-së.

Në këtë ceremoni morën pjesë zy-
rtarë të lartë të SHPK-së si dhe ud-
hëheqësit e këtyre njësiveve.

Që nga krijimi i këtyre njësiveve e deri
tani është arritur progresi i nevo-
jshëm dhe përgatitjet e parapara për
tranzicionimin e këtyre dy njësiveve të
specializuara të SHPK-së.

Njësitit K-9 në kuadër të SHPK-së ka fil-
luar punën që nga nëntori i vitit 2002.
Të gjithë pjesëtarët e SHPK-së të këtij
njësiti (që për momentin janë 19

pjesëtarë) kanë kryer trajnime të
veçanta brenda dhe jashtë vendit.

Pesë pjesëtarët e parë të SHPK-së të
këtij njësiti ose gjenerata e parë e K-
9-shit ka përfunduar trajnimin në Bri-
taninë e Madhe (Melton Moëbray,
Qendra Mbretërore e Mbrojtjes së
Kafshëve për një muaj) për mbajtës të
qenit si dhe trajnimin për ushtrimin e
qenit.

Tani, trajnimi i njëjtë bëhet në Qen-
drën për Siguri Publike në Vushtri me
ndihmën e instruktorëve ndërkombë-
tarë dhe atyre të SHPK-së.

Edhe Njësitit Mbështetës Operativ ka
përfunduar me sukses trajnime të
ndryshme që kanë qenë të nevo-

jshme për përgatitjen profesionale të
këtyre pjesëtarëve. Shërbimi Policor i
Kosovës numëron deri tani 370 oficer
të NJMO-së të cilët janë të ndarë në
11 togje.

Në fjalimin e rastit të mbajtur me
rastin e ceremonisë së tranzicionit të
këtyre dy njësiveve u cek rëndësia e
njësive të specializuara për punën e
një policie demokratike, kurse pjesë-
tarët e njësimit K-9 dhe të NJMO-së të
SHPK-së, krahas urimeve që morën,
ata u zotuan se do të vazhdojnë me
përkushtim dhe vendosmëri të krye-
jnë detyrat e tyre në shërbim të qytet-
tarëve të Kosovës drejt përmbushjes
së misionit dhe vizionit të SHPK-së.





MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME PRITI KREUN E SHËRBIMIT POLICOR TË KOSOVËS

Ministri i Punëve të Brendshme, Zenun Pajaziti dhe zëvendësministri Fatmir Xhelili e pritën kreun e Shërbimit Policor të Kosovës, të cilit i printe zëvendëskomisari i Policisë, gjeneral nënkolonel Sheremet Ahmeti. Në këtë takim morën pjesë edhe udhëheqësit e shtyllave tjera të SHPK-së.

Ministri i Punëve të Brendshme, Zenun Pajaziti pasi e përshëndeti kreun e lartë të Shërbimit Policor të Kosovës, theksoi se që nga pranimi i postit të ministrit, jam në fazën e njohjes me përgjegjësit e SHPK-së dhe ne po vazhdojmë të mbajmë vazhdimësinë e punëve dhe aktiviteteve.

Duke folur për rolin dhe rëndësinë e Shërbimit Policor të Kosovës për shoqërinë kosovare, ministri Pajaziti potencoi se objektivat do të arrihen së bashku:

"Jam i sigurt që ju keni objektiva për të patur një polici të dashur për të gjithë qytetarët e Kosovës. Ne jemi

"Mesazhet e kabinetit tim dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme duhet të jenë të qarta. Nuk do të ketë politikë në policinë e Kosovës. Kemi marrë obligime nga qytetarët e Kosovës që të luftojmë krimin dhe korrupsionin në shoqërinë tonë", theksoi ndër të tjera ministri Pajaziti.

ata që japim përgjegjësi në Parlamentin e Kosovës për sigurinë në Kosovë dhe duhet të bëjmë përpjekje të përbashkët për t'i arritur objektivat".

Duke i dhënë rëndësi të veçantë depolitizimit të Shërbimit Policor të Kosovës, ministri i Punëve të Brendshme, Zenun Pajaziti theksoi se "mesazhet e Kabinetit tim dhe të Ministrisë së Brendshme duhet të jenë të qarta. Nuk do të ketë politikë në policinë e Kosovës. Kemi marrë obligime nga qytetarët e Kosovës që të luftojmë krimin dhe korrupsionin në shoqërinë tonë. Ministri i Punëve të Brendshme, para kreut të lartë të SHPK-së rëndësi të veçantë i kushtoi edhe komuniteteve joshqiptare që punojnë në Shërbimin Policor të Kosovës. "Na gëzon fakti që 16 për qind e pjesëtarëve të SHPK-së i tako-

jnë komuniteteve. Kjo nuk duhet të kuptohet vetëm për efekt politik, por është situatë reale".

Në vazhdim, zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Fatmir Xhelili në fjalën e tij para kreut të SHPK-së theksoi se "na gëzon rritja dhe strukturimi profesional i SHPK-së dhe jemi të përkushtuar për një polici të suksesshme e cilësore. E dimë që pjesëtarët e SHPK-së kanë paga të ulëta, por përkrahja jonë nuk do të mungojë", theksoi zëvendësministri Xhelili.

Në fund të takimit, zëvendëskomisari i Policisë, gjeneral nënkolonel Sheremet Ahmeti pasi e falënderoi ministrin Pajaziti për pritje shprehu përkushtimin e tij dhe të kreut të SHPK-së në kryerjen me sukses të detyrave dhe përgjegjësi të policisë para qytetarëve të Kosovës.



ATA NUK HARROHEN KURRË

Zyrtarë të MPB-së dhe oficerët e lartë të SHPK-së shpërndanë dhurata për fëmijët e policëve të rënë duke u zotuar se kujdesi institucional nuk do të mungoj asnjëherë për familjet e tyre.

Në ambientet e sallës solemne të Qeverisë së Kosovës, ish ministri i Punëve të Brendshme, z. Blerim Kuçi shpërndau dhurata për fëmijët e policëve të rënë në detyrë me rastin e festave të fundvitit.

Në këtë solemnitet rasti morën pjesë edhe Zëvendës-komisari i Policisë, gjeneral nënkolonel, Sheremet Ahmeti, kolonel Ahmet Hasi, komandant i Policisë Rajonale në Pejë, Elmina Mahmuti, komandante e policisë Rajonale në Gjilan, Valbona Kamberi, kryetare e Sindikatës së Pavarur të SHPK-së dhe oficerë e familjarë të policëve të rënë në detyrë.

Z. Blerim Kuçi, pasi i përshëndeti të pranishmit e në veçanti fëmijët dhe familjarët e policëve të rënë në detyrë, theksoi se ju kemi ftuar sot që t'ua urojmë festat e fundvitit, duke shtuar se Ministria e Punëve të Brendshme dhe Shërbimi Policor i Kosovës do t'i kujtojë gjithmonë pjesëtarët e Shërbimit Policor të Kosovës të rënë në detyrë,

duke theksuar se kujdesi institucional nuk do të mungoj asnjëherë për familjet e tyre.

Të përkujtojmë se për ceremoninë e shpërndarjes së dhuratave janë ftuar familjet e policëve të rënë në detyrë si ajo e Lazim Rexhepit, Isuf Haklajt, Ilir Llapashticës, Danush Hasanit, Abedin

Mustafës, Hajdar Ahmetit, Driton Mehanës, Avni Kasumit, Sebahate Tolajt, Arsim Rustollit dhe Triumf Rizës.

Pas shpërndarjes së dhuratave, për fëmijët e policëve të rënë në detyrë dhe familjarët e tyre, Ministria e Punëve të Brendshme organizoi edhe një koktej për këta familjarë.



PLANI STRATEGJIK 2008-2010

Puna në hartimin e Planit Strategjik është iniciuar nga ana e Komisarit të Policisë dhe Z. Komisari i SHPK-së, dhe Iniciativa është kuptuar seriozisht nga Bordi Ekzekutiv i SHPK-së, si dhe Drejtoria për Analizë të Politikave të SHPK-së, e cila është themeluar dhe ngarkuar për hartimin e tij.

Plani strategjik është një dokument dinamik, i cili paraqet vizionin e Policisë si organizatë në përgjithësi si dhe vizionin e përbashkët të të gjitha shtyllave të SHPK-së, në zbatimin dhe respektimin e ligjeve të mbështetura në parimet e demokracisë, profesionalizmit dhe transparencës së punës.

Mënyra se si Policia i kryen detyrat e saj dhe për më shumë se çfarë bëjnë ata është një indikator i respektit të tyre ndaj të drejtave të individit, një mirënjohje për autoritetin që u është besuar atyre nga bashkëqytetarët dhe një obligim që përkrahë standardet më të larta të shërbimit publik.

SHPK- synon në krijimin e një policie të aftë profesionalisht, të paanshme politikisht, fleksibil dhe dinamike në veprim, për të mbrojtur rendin dhe sigurinë publike dhe garantuar zbatimin e ligjit në të gjithë vendin, duke respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut.

Procedura dhe objektivat e planit strategjik u përcaktuan në përputhje me strukturën organizative funksionale. SHPK-ja veprimtarinë e vet e mbështetë në parim të barazisë, neutralitetit politik dhe paanshmërisë, sinqeritetit dhe përgjegjshmërisë, transparencës, meritave, mos diskriminimit dhe gjithë përfshirjes.

Moto e Shërbimit Policor të Kosovës është mbrojtja e Popullit të Kosovës përmes zbatimit të ligjit. Plani Strategjik i SHPK-së, 2008 - 2010 paraqet qëllimet, objektivat dhe strategjinë që do të drejtojnë aktivitetet e SHPK-së gjatë kësaj periudhe. Plani po ashtu synon të vendosë edhe detyrat konkrete për organizim, funksionim të SHPK-së, me qëllim që ajo të forcohet si burimi kryesor i orientimeve policore në planifikim, udhëheqje, menaxhim, koordinim, kontrollim, vlerësim dhe mbikëqyrje.

Krijimi i Planit Strategjik po ashtu ka për qëllim të ndikojë në krijimin e një Shërbimi Policor profesional dhe të besueshëm me qëllim :

• *ndërtimi i një strukture organizative të policisë e cila duhet t'i shërbejë planit strategjik dhe anasjelltas për të planifikuar të ardhmen e organizatës policore dhe për ta përcjellur*

përformancën në arritjen e objektivave strategjike.

• *forcimi i kualitetit dhe efektivitetit të policisë dhe ngritja e performancës duke e bërë policinë më të përgjegjshme dhe transparente për të gjithë pjesëtarët e SHPK-së.*

• *krijimi i një policie me një strukturë koherente, të qëndrueshme, të përgjegjshëm në zbatimin e ligjit, e përshtatshme në nevojën e ndryshimit organizacional dhe me një nivel të gjykimit të pranuar nga shoqëria.*

• *krijimi i infrastrukturës së nevojshme ligjore dhe mbështetja tjetër legale në interes të shërbimit si: ofrimi i ndihmës juridike të nevojshme, krijimi i bazës ligjore.*

• *ngritja e nivelit të disiplinës për të gjithë të punësuarit në SHPK, parashikimi dhe parandalimi i shkeljeve disiplinore, krijimi i infrastrukturës për të mundësuar një veprim më efikas kundër shkeljeve disiplinore.*

• *ngritja e kualitetit të shërbimit në harmoni me standardet e të drejtave të njeriut, parimet e përgjegjësisë ndaj qytetarit si dhe në pajtim me parimet e policimit demokratik.*

• *qëllimi strategjik do të jetë në funksion të ofrimit të SHPK-së sa më afër standardeve të bashkimit evropian si zbatues të ligjit.*

Ky plan strategjik është rezultat i përpjekjeve kolektive të të gjitha shtyllave ekzistuese, departamenteve, drejtorive dhe struktura të tjera të cilat ofruan qëllimet, objektivat dhe aktivitetet e tyre për të ardhmen e SHPK-së.

Duke pasur parasysh se ky është planifikimi i parë i tillë në SHPK nga pjesëtarët e saj, ekipi është kujdesur që të ofroj një metodë të konsultimit me të gjithë në mënyrë që të identifikohen qëllimet dhe objektivat e organizatës.

Në fillim është përcaktuar vizioni i SHPK-së, misioni, vlerat si dhe objektivat kryesore strategjike të cilat u aprovuan nga Bordi Ekzekutiv i SHPK-së dhe kështu e hapen rrugën në përpilimin e planit.

Më vonë u kërkuar objektiva dhe informacione nga Departamentet dhe Drejtorit dhe Njësitet tjera lidhur me qëllimet dhe objektivat për të ardhmen.

Plani strategjik është dokument udhëzues për veprim afatgjatë të SHPK-së, që përmban përshkrimin e rrugës së ndërtimit, zhvillimit, ruajtjes dhe performancës në drejtim të përmbushjes së misionit, vizionit dhe objektive të SHPK-së. Plani strategjik përbëhet prej disa elementeve kryesore të cilat janë shumë të rëndësishëm në ndërtimin dhe qëndrueshmërinë e tij si: Deklarata e Misionit, Vizioni, Vlerat, Qëllimet, Strategjia – Orientimet

Strategjike, Objektivat, Qëllimet – Mandatat, Pengesat e mundshme, Buxheti dhe nw fund Implementimi – Mbikëqyrja.

SHPK-ja wshtw e vetëdijshme se gjatë realizimit praktik të këtij Plani strategjik, mund të përballet me pengesa të pritura dhe të paparashikuara.

Si sfida kryesore që mund të paraqiten janë supozuar: mungesa e infrastrukturës së kompletuar ligjore, buxheti i limituar për financimin e trajnimeve, projekteve dhe programeve të ndryshme, procesi i tranzicionit nga UNMIK në SHPK, mungesa e pajisjeve të mjaftueshëm për njësitë të specializuara, humbja e kuadrit profesional dhe mirëqenia e të punësuarve,

Në mënyrë që aktivitetet të rrjedhin drejtë realizimit të

qëllimeve sipas planit është shumë me rëndësi që për aktivitetet dhe rezultatet e arritura të vendoset përgjegjësia për implementim të planit.

Kjo fushë kryesore e rezultateve implementohet përmes strategjive kryesore të vendosura nga grupi punues i hartimit të këtij plani strategjik.

Udhëheqësit e Shtyllave përkatëse duhet të, hartojnë dhe implementojnë Planin e veprimit vjetor të mbështetur në këtë plan strategjik. Të gjithë Udhëheqësit /Mbikëqyrësit dhe të punësuarit, duhet të punojnë së bashku në implementim të planit dhe janë të përgjegjshëm për zbatim.

Bordi Ekzekutiv miraton planin strategjik dhe mban përgjegjësi për realizimin dhe vlerësimin e planit.

Mbikëqyrjen e implementimit e bënë Drejtoria për Analiza të Politikave të SHPK-së.

Vlerësimin e gjithmbarshëm të implementimit të planit strategjik e bënë: Komisari i Policisë dhe Z/Komisari i SHPK-së.

Mbikëqyrja e realizimit dhe progresit të arritur në raport me planin strategjik, bëhet çdo tre (3) muaj, duke filluar nga niveli i zbatimit deri te niveli mbikëqyrës.



BASHKËPUNIMI çelësi i suksesit të SHPK-së

TEMA KRYESORE



Aktivitetet policore që janë duke u zhvilluar muajve të fundit përveç ofrimit të sigurisë ndërlidhen edhe me zhvillimet politike në Kosovë. Në disa edicione të Mbrojtësit kemi trajtuar pikërisht këto aktivitete të policisë që në bashkëpunim edhe me partnerët tjerë relevant në këtë fushë kanë për qëllim ruajtjen e jetës, pronës dhe rendin e qetësinë publike në Kosovë.

Në shumë takime me institucione vendore dhe ndërkombëtare në Kosovë

që janë organizuar për diskutime rreth sigurisë në Kosovë, është diskutuar për planet e ndryshme të policisë në këtë fazë të rëndësishme për Kosovën. Kështu, në fund të janarit të këtij viti, udhëheqës të SHPK-së u takuan me Kryeministrin Thaçi i cili SHPK-në e cilësoi si “një tregim të suksesshëm” duke siguruar se ky institucion është duke i koordinuar të gjitha aktivitetet me MPB-në. Në këtë takim Zv.Komisari i SHPK-së – Sheremet Ahmeti e njoftoi Kryeministrin për përgatitjet intensive

për krijimin e një ambienti të qetë dhe të sigurt për të gjithë qytetarët duke pohuar se SHPK-ja është në nivelin më të lartë të përgjegjësisë të kryerjes së detyrave.

Një takim tjetër i rëndësishëm ishte edhe ai me udhëheqësit e pushtetit lokal. Në bashkëpunim me Asociacionin e Komunave dhe Stafin e Policisë, në “Hotel Palace” në Mitrovicë, u mbajt takimi me Kryetarët e Komunave.

Të pranishmit kishin një agjendë të ngjeshur të çështjeve për ti diskutuar përfshirë këtu situatën e përgjithshme të sigurisë në Kosovë, njoftimin me problemet e ndryshme në aspektin e sigurisë e sidomos të përgatitjeve të planeve të ndryshme për siguri në prag të zgjedhjes së statusit final të Kosovës.

Në fjalën hyrëse të këtij takimi, Komisari i Policisë z.Richard Monk ceku rëndësinë e takimeve të tilla duke potencuar se elementi më i rëndësishëm për sigurinë në Kosovë qëndron tek komuniteti dhe policia:

“Unë mendoj se elementi më i rëndësishëm për sigurinë në Kosovë qëndron te komuniteti dhe policia. Unë vazhdimisht jam duke përsëritur shprehjen se “popullata dhe policia duhet të qëndrojnë së bashku”. SHPK-ja është e angazhuar dhe është duke kryer shumë mirë detyrën në baza ditore - theksoi Komisari i policisë ndër të tjera duke thënë se qëllimi kryesor i tij është që përgjegjësitë të kalojnë sa më shpejt te SHPK-ja.

Edhe zv.Komisari i SHPK-së, Sheremet Ahmeti theksoi se takime të tilla janë shumë të rëndësishme duke dhënë një vlerësim për gjendjen e sigurisë:

“Gjendja e sigurisë në Kosovë është e qetë, dhe këtë e kemi arritur në bashkëpunim me qytetarët kosovar. Një sferë shumë e rëndësishme është edhe bashkëpunimi në mes institucioneve dhe policisë, përfshirë këtu edhe komunat si një segment shumë i rëndësishëm. SHPK-ja ka përgatitur edhe planin strategjik 2008-2010 dhe synon që të forcojë edhe më tej partneritetin me komunitetin, të luftojë krimin, korrupsionin, të ruaj rendin dhe qetësinë, pastaj të merr kompetencat nga policia e UNMIK-ut dhe të krijoj partneritet me misionin e ardhshëm të BE-së”- theksoi ndër të tjera Zv.Komisari i SHPK-së Gjeneral nënkolonel Sheremet Ahmeti.

Gjeneral major Reshat Maliqi, duke dhënë shpjegime lidhur me rregulloren 2005/54 që ka të bëjë edhe me bashkëpunimin e pushtetit lokal me policinë dha edhe disa shpjegime lid-

hur me përgatitjet e policisë në prag të zgjedhjes së statusit final të Kosovës:

“Objektivat e policisë që janë dhe do të mbesin edhe në të ardhmen janë mbrojtja e jetës së qytetarëve, mbrojtja e pronës së tyre, mbajtja e rendit dhe qetësisë publike, ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe fetare, rritja e patrullimeve policore sidomos në ato në këmbë me qëllim të një komunikimi dhe bashkëpunimi më të mirë me qytetarë dhe ngritjes së ndjenjës së sigurisë të qytetarët. Në këtë drejtim ne kemi përgatitur planet tona dhe kemi një shtrirje të këtyre planeve në tërë territorin e Kosovës”. -theksoi z.Maliqi.

Ndër folësit e tjerë ishte edhe gjeneral major Rahman Sylejmani nga shtylla e krimeve i cili bëri një përmbledhje të rasteve më të rëndësishme dhe të rezultateve të arritura. Ai ndër të tjera ceku se policia do të vazhdojë të punoj në mënyrë proaktive në luftimin dhe parandalimin e krimit.



Pamje nga debati në radion 'Zëri i Shtimjes' - Shtimje

Ndërkaq nga ana e kryetarëve të komunave, struktura policore është siguruar se do të ketë bashkëpunim të mirëfilltë dhe të përhershëm me ta në të gjitha aspektet, përfshirë këtu edhe gjetjen e një zgjidhje të përhershme të objekteve policore.

Pas takimit që është mbajtur me zëdhënësit e institucioneve në lokalet e policisë më 25 janar është dhënë ideja që komandantët e stacioneve të jenë bashkë me kryetarët e komunave nëpër medime lokale dhe atë në tërë nivelin lokal në Kosovë dhe të diskutojnë për çështje të sigurisë krahas edhe problemeve të tjera që qytetarët do të mund ti adresonin në këto emisione të drejtpërdrejta në radio dhe televizione lokale.

"Në këto prononcime të përbashkëta me nivelin e pushtetit lokal janë diskutuar dhe po diskutohen ende çështje

të sigurisë por edhe për çështjen e statusit të Kosovës. Është mirë që qytetarët të shohin dhe dëgjojnë se SHPK-ja si institucion ekzekutiv dhe institucionet e zgjedhura nga votat e qytetarëve janë në një linjë që dmth se janë unik në mbrojtjen e rendit dhe qetësisë publike dhe ruajtjen e jetës dhe të pronës. Në këto takime është adresuar mesazhi se nëse do të festohet kjo të bëhet në mënyrën e duhur, por edhe nëse ka vend për pakënaqësi edhe kjo të bëhet në suaza ligjore dhe të mos del jashtë kontrollit." - theksoi zëdhënësi i SHPK-së Veton Elshani i cili është një ndër ideatorët e një mënyre të tillë të komunikimit me qytetarët kosovar. Ai më tutje theksoi se qytetarëve po u bëhet çdo ditë me dije se dhuna nuk do të tolerohet sikurse nuk do të tolerohen edhe bllokada të ndryshme të rrugëve.

Biseda e parë e këtij lloji është bërë më 30 janar, ku pjesëmarrës në një emision të drejtpërdrejtë ishin komandanti dhe kryetari i komunës së Kamenicës. Pas kësaj kjo vazhdoi edhe në rajonet e tjera si në Pejë, Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj, Prizren etj.

"Qëllimi i gjithë kësaj ishte se duke parë aktivitetet e mëdha që janë duke u bërë në mediat qendrore në Prishtinë, është parë e arsyeshme që kjo iniciativë të vazhdohet edhe në nivel lokal duke pasur parasysh se niveli lokal i ka dëgjuesit dhe shikuesit e vet. Qytetarët kanë dëgjuar dhe vazhdojnë të dëgjojnë mesazhet nga njeriu i parë për siguri dhe i pari i komunës në ato nivele lokale. Deri tani nga informatat kthyesë që ne i kemi marrë nga qytetarët kjo iniciativë është pritur mjaft mirë." - theksoi z.Elshani.



Pamje nga debati në radion 'Zëri i Rinisë' - Novobërdë



Pamje nga takimi me pushtetin lokal në Hotel Palace, Mitrovicë

Ky projekt filloi si pilot projekt dhe ishte një përvojë e re për policinë kosovare. Elshani pohon se kjo iniciativë është marrë në prag të zgjedhjes së statusit të Kosovës por duke parë rezultatet e arritura, në të ardhmen iniciativa të tilla mund të merren edhe nga vet komandantët e stacioneve policore dhe të menaxhohet në nivel rajonal.

Krahas debateve dhe diskutimeve në media, në kuadër të kësaj janë mbajtur edhe debate me qytetarë. I tillë ishte debati i hapur me kryetarët e partive politike që veprojnë në komunën e Klinës, me kryetarët e shoqatave të UQK-së dhe me komandantin e TMK-së - njësia në Klinë.

Në takim kanë marrë pjesë edhe zyrtarë të KFOR-it, administratës së UNMIK-ut, OSBE-e dhe zyrtarë të mediae.

Kryetari i komunës z.Sokol Bashota dhe komandanti të stacionit të Klinës - kapiten Agron Hasaj, në fjalime të ndara i janë adresuar të pranishmëve për angazhimet që janë duke u bërë

këto ditë dhe javët në vijim në funksion të mbajtjes së rendit dhe qetësisë në këtë komunë, për planifikimin dhe koordinimin e veprimeve të përbashkëta dhe në të njëjtën kohë duke u bërë thirrje të gjithëve që të japin kontributin e tyre në këtë drejtim.

Në kuadër të takimeve të planifikuara dhe adresimin tek qytetarët e Klinës, kapiten Hasaj së bashku me kryetarin e komunës së Klinës z.Sokol Bashota kanë zhvilluar edhe debate të hapura me banorë serb në fshatin Dresnik të Klinës dhe në lokacione tjera të banuara me minoritete. Ky takim është zhvilluar në një shtëpi private të një banori serb në qendër të fshatit, kanë marrë pjesë rreth 35 banorë të komunitetit serb, po ashtu në takim ishin prezent edhe zyrtarë të KFOR-it, UNMIK-ut, OSBE-së.

Nga zyrtarë të policisë këto angazhime konsiderohen mjaft të rëndësishme.


“Kjo është një “portë” e re e cila është hapur për ngritjen e nivelit të

bashkëpunimit në mes policisë dhe pushtetit lokal, por pika më e rëndësishme qëndron tek komunikimi i drejtpërdrejt me qytetarë në këto emisione të organizuara në debate, radio dhe televizione lokale anembanë Kosovës. Mendoj se është mirë që kjo portë të qëndroj gjithmonë e hapur për një komunikim të mirëfilltë me qytetarë” – tha ndër të tjera zëdhënësi i SHPK-së kapiten Veton Elshani.

Policia do të vazhdojë të kërkojë dhe të gjejë mënyra të ndryshme të komunikimit me qytetarë. Komunikimi i mirëfilltë do të ketë ndikime pozitive për zhvillimet e tashme dhe ato në të ardhmen e afërt duke dërguar edhe porosi të qarta se dhuna nuk do të tolerohet. Kjo do të ndikojë edhe në ngritjen e besueshmërisë të qytetarëve në organet e veta të sigurisë dhe do të ndikojë në kredibilitetin e SHPK-së si shërbim i ri, i qëndrueshëm dhe efektiv në ruajtjen e rendit dhe qetësisë në Kosovë.

MBROJTËSI

Sektori i Auto-krimeve **NË GJILAN-SFIDAT DHE SUKSESET**



Të gjitha policitë evropiane ditëve të sotme janë duke u ballafaquar me sfidën në luftën kundër vjedhjes së automjeteve dhe shumica prej tyre edhe kanë hartuar plane strategjike për parandalimin e futjes dhe të legalizimit të mjeteve motorike të vjedhura, kryesisht të makinave të luksit, si dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të abuzuesve të deritanishëm.

Por duhet pranuar se poseduesit e këtyre makinave luksoze në të shumtën e rasteve janë vetëm "klientë" të trafikimit ilegal të makinave të vjedhura, të cilët si pasojë e papërgjegjshmërisë së tyre, për të harxhuar rreth 20% më pak para, pranojnë të blejnë makina të vjedhura. Duke blerë makina të vjedhura, këta "klientë", me para në shumë raste të ndershme, fuqizojnë pa dashje "mafien e makinave", dëmtojnë bizneset serioze e të ligjshme të makinave në vendin tonë dhe e vënë veten e tyre në një pozicion ku bien në konflikt me ligjin, pasi janë posedues të një mjeti të vjedhur.

Një strategji e mirëfilltë për luftën kundër trafikut të mjeteve motorike të vjedhura do të duhej të zgjidhë tre probleme kryesore:

Së pari-Parandalimi i futjes në Kosovë të mjeteve motorike të vjedhura.

Së dyti-Parandalimi e legalizimit (targimit) të mjeteve motorike të vjedhura.

Së treti-përcaktimin e

mekanizmave për vënien para përgjegjësisë ligjore të personave përgjegjës për legalizimet e deritanishme. Edhe në kuadër të SHPK-së tani e disa vite funksionon Sektori i Auto-Krimeve që vazhdon punën në luftimin e kësaj dukurie. Në këtë numër të radhës të Mbrojtësit ne intervistuar udhëheqësin e njësitit të Auto-krimeve në rajonin e Gjilanit - rreshterin Fatmir Bajramin i cili na ndihmoi që të kuptojmë më shumë për këtë dukuri. Ai që nga viti 2006 punon aty së bashku me dy hetues: oficerët Sherif Arifi dhe Sevdije Kosumi.

Cilat janë disa nga detyrat me të cilat ju sfidoheni gjatë kryerjes së punës suaj?

Rreshter Bajrami: Detyrë e jona është që t'i hetojmë të gjitha veprat penale të cilat kanë të bëjnë me Sektorin e Auto-Krimeve si psh.: falsifikimi i dokumenteve, pranimi i mallrave të vjedhura, mashtrimi, legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë dhe shmangien ose ikjen e obligimeve doganore. Gjithashtu ne hetojmë edhe vjedhjet e automjeteve të kërkuara nga policitë e vendeve të ndryshme evropiane dhe më gjerë përmes zyrës ndërlidhëse të Interpolit në Prishtinë.

Natyrisht se detyra të tilla nuk mund të kryhen pa një bashkëpunim të mirëfilltë.

Me cilat njësite bashkëpunon sektori juaj?

Rreshter Bajrami: Ne si



sektor i Auto-Krimeve bashkë-punojmë ngushtë me Njësitin e Auto-Krimeve Qendrore në Prishtinë, me të gjithë sektorët regjional në nivel të Kosovës, pastaj me njësitet e hetimeve kriminale dhe Zyrën Ndërlidhëse të Interpolit në Prishtinë.

Në cilën pjesë të regjionit ka pasur raste më të shpeshta të veturave të vjedhura të kërkuara ndërkombëtarisht?

Rreshter Bajrami: Më së shumti raste kemi pasur në Gjilan, në territorin e Vitisë, si për shembull në fshatin Mogillë dhe Smirë.

A janë rastet e shpeshta kur të dyshimtit janë arrestuar në tentativë për të kaluar kufirin me automjet të vjedhur?

Rreshter Bajrami: Kemi pasur disa raste ku nga policia kufitare janë ndaluar të dyshuarit duke transportuar automjetet e vjedhura në Kosovë për në Serbi, posaçërisht dua ta cek Portën V dhe VI të pikave doganore. Si rast më i freskët është ai në Portën V (Dheu i Bardhë) ku nga policia kufitare është arrestuar i dyshuari duke

transportuar automjetin e vjedhur Audi A-6, prodhim i vitit 1999, pronë e një qytetari nga Prishtina. Pas identifikimit të automjetit është njoftuar njësia e Hetimeve Kriminale në Prishtinë, dhe pas kompletimit të rastit, verifikimit të të dhënave për automjetin ai i është kthyer pronarit legjitim.

Çfarë rezultate keni shënuar në luftimin e vjedhjes së automjeteve?

Rreshter Bajrami: Gjatë vitit 2006 nga sektori ynë janë iniciuar gjithsej 121 raste prej të cilave 20 raste janë me të dyshuar të panjohur. Prej tyre, automjete të vjedhura të kërkuara ndërkombëtarisht i kemi pasur tri raste. Gjatë 2007-ës falë punës së palodhshme të patrullave dhe të sektorit tonë, kemi rënë të dukshme të rasteve dhe atë vetëm 36 raste të iniciuara. Prej tyre kemi 13 automjete të konfiskuara, ku 5 automjete u janë kthyer pronarëve legjitim ndërsa të tjerat gjenden në autoparkun e SHPK-së dhe komunës në pritje të vendimit të gjykatës.

Nga: Zyra për Informim Rajoni i Gjilanit



Me ushtrime të përbashkëta SË PROFESIO-

Instruktorët e njësise MSU, vazhdojnë të bashkëpunojnë pandërprerë me Shërbimin Policor të Kosovës.

Muaj më parë, pjesëtarët e Njësise për Mbrojtje të Afërt të SHPK-së përfunduan me sukses Trajnimin për Mbrojtje të Afërt, i cili me kërkesë nga Departamenti i Trajtimeve të SHPK-së pranë QKSPEZH, u organizua nga karabinierët italianë të Njësise MSU.

Më vonë, me iniciativë të Departamentit të Trajnimve të SHPK-së, përmes Komisarit të policisë së UNMIK-ut, është bërë një kërkesë për organizimin e një trajnimi për kontrollimin e turmave të Njësise

Mbështetëse Operative (NJMO) të SHPK-së.

Në këtë rast Njësia MSU, organizoi trajnimin për kontrollimin e turmave të ashtuquajtur "KPS Reserve Platoon CRC Training", i cili filloi të mbahet në tetor të vitit 2007 dhe do të vazhdojë gjer në muajt e parë të vitit 2008. Pjesa teorike dhe praktike e trajnimit mbahet në Qendrën për Siguri Publike, në Vushtrri.

"Teknikat dhe Taktikat për kontrollimin e turmave" është trajnimi që vazhdon të mbahet edhe më tutje nga njësia MSU e karabinierëve italian. Ky trajnim u organizua për togjet rezervë të NJMO-së.

Për të kuptuar më shumë rreth këtyre tra-

jnimeve të pjesëtarëve të SHPK-së intervistuar Togerin Doanto Pontassuglia nga njësia MSU e karabinierëve italian.

Çka konsideroni se është prioritet i këtij trajnimi?

Tog/Pontassuglia: Qëllimi kryesor i këtij trajnimi është aftësimi sa më i mirë i policëve të SHPK-së, në mënyrë që të jenë sa më profesional gjatë kryerjes së detyrës, dhe në raste të trazirave. Policët që ndjekin këtë trajnim janë togje rezervë të NJMO-së, të cilët duhet të kenë bashkëpunim sa më të mirë në terren me njësitë speciale të policisë.

AUTOBIOGRAFI

Donato Pontassuglia u lind në vitin 1980, në qytetin Castellaneta, në jug të Italisë. Në moshën 16 vjeçare ai ka ndjekur për tri vite Shkollën Ushtarake, në Milano.

Në moshën 20 vjeçare pas përfundimit të një trajnimit për oficerë, ai ushtroi detyrën e eprorit të ushtrisë për një periudhë të shkurtë kohore.

Në moshën 21 vjeçare ai u inkadrua në tek karabinierët, periudhë kjo në të cilën ai ndoqi studimet për dy vjet në Shkollën Ushtarake, në qytetin Modena dhe më pas ai vazhdoi studimet për epror, në Shkollën Ushtarake, në Romë të Italisë.

Në korrik të vitit 2006, diplomoi në Jurisprudencë. Në gusht të po këtij viti, u caktua në batalionin e pestë në krahinën Emilia Romana me seli në Bolonjë. (Kjo është një njësi e armës së karabinierëve e cila merret me kontrollimin e rendit

publik si dhe mbështet vendet sipas nevojës nëpër tërë territorin e Italisë).

Më 29 mars 2007, tog/Donato Pontassuglia erdhi me mision në Kosovë dhe i përket regjimentit MSU, në kuadër të të cilit është përgjegjës i njësisë e cila merret me trajnime të ndryshme të specializuara. Gjatë kësaj periudhe, z.Pontassuglia me kolegët e tij instruktorë, filluan trajnimet për pjesëtarët e SHPK-së.

Fillimisht startuan me trajnimin e ashtuquajtur "Close Protection" i cili u mbajt me Njësinë për Mbrojtje të Afërt të SHPK-së, duke vazhduar më tutje me trajnimet: "Monitorimi i Njësisë O.S.U", "Groud Commander Course" – trajnim ky në të cilin ishin përfshirë krerët e SHPK-së, si dhe "Teknikat dhe taktikat për kontrollimin e turmave", trajnim ky i cili vazhdon edhe më tutje të zhvillohet për togjet rezervë të SHPK-së.

drejt aftësimit dhe ngritjes

NALIZMIT

SHPK vazhdon trajnimet me MSU-në italiane

Prioritet të trajnimit në këtë rast mund ta konsiderojmë rritjen e cilësisë profesionale të pjesëtarëve të SHPK-së që përballen me rrethana sikurse janë trazirat.

Si ndikon ky trajnim në imazhin e SHPK-së?

Tog/Pontassuglia: Ky trajnim sikurse edhe çdo trajnim shtesë i specializuar ndikon shumë në ngritjen e imazhit të SHPK-së, në këtë rast ky trajnim është dedikuar për mbajtjen e qetësisë dhe rendit publik. Qëllimi i këtij kursi është që të parandalojë ngjarjet që mund të jenë tragjike në kuadër të trazirave. Me këto tra-

jnime SHPK do ta rrisë shkallën e kapaciteteve, duke përmirësuar imazhin e tyre. SHPK-ja është një forcë e policisë shumë e re, por në të njëjtën kohë e ka një nivel të profesionalizmit shumë të lartë. Fakti që SHPK-së çdo ditë i shtohen kurse të ndryshme, kjo nënkupton që kreut të SHPK-së i fle në shpirt dhe synon që sa më mirë të trajnohen pjesëtarët e këtij shërbimi. Në koordinim me policinë e UNMIK-ut dhe Departamentin e Trajnimeve të SHPK-së, ne për një periudhë kohore jemi duke luajtur rolin e vëzhguesit (monitoruesit) të njësisë NJMO, dhe kjo pasqyron dëshirën e madhe të tyre në ngritjen e shkallës së profesionalizmit të SHPK-së.

Departamenti i Trajnimeve të SHPK-së, në bashkëpunim me QKSPEZH, i kushtojnë rëndësi të veçantë bashkëpunimit dhe koordinimit të trajnimeve dhe në këtë rast ne kemi mjaft përkrahje.

A mund ta përshkruani një ditë të kursit, çfarë bëjnë pjesëmarrësit që nga mëngjesi e deri në orët e pasdites?

Tog/Pontassuglia: Trajnimi fillon në ora 09:00, fillimisht disa orë mbajmë ligjëratat teorike dhe me pas në zona trajnuese (poligonet e trajnimit) përballemi me argumente, që do të thotë bëhet ballafaqimi i teorisë me praktikë.

Si do t'i vlerësoni ju rezultatet e trajnimit?

Tog/Pontassuglia: Angazhimi im me trajnimet e tilla ka pasur për qëllim zgjerimin e kapaciteteve të SHPK-së, në zgjerimin e njohurive për Njësinë për Mbrojtje të Afërt dhe NJMO-të. Unë jam shumë i kënaqur sepse kam hasur në mirëkuptim dhe profesionalizëm të nivelit të lartë duke filluar nga komandanti e gjer tek policët. Për mendimin tim rezultatet e trajnimeve që kanë përfunduar kanë qenë të shkëlqyeshme.

Ndërkaq, trajnimet të cilat ne jemi duke i mbajtur me personelin shtesë të NJMO-ve, pritet të rezultojnë mirë, sepse nëse trajnimi zhvillohet në mënyrë profesionale natyrisht që edhe rezultatet do të jenë të mira. Mirëpo, në këtë rast, terreni jashtë është ai që tregon rezultatet e policëve që kanë ndjekur këtë trajnim, sepse ballafaqohen me raste siç janë trazirat. Qëllimi kryesor i instruktorëve të MSU-së është që ta ndihmojë SHPK-në që të shtojë kapacitetet, në mënyrë që ata t'i përballojnë situatat e trazirave në mënyrat më të mira të mundshme. Në muajin korrik të 2007-ës ne kemi mbajtur edhe trajnimin "Ground Commander Course", kurs ky në të cilin morën pjesë epororët e SHPK-së dhe që përfundoi me mjaft sukses. Ndërkaq



tani jemi duke mbajtur në vazhdimësi trajnimin "Teknikat dhe Taktikat për kontrollimin e turmës", kurs ky i cili deri më tani ka rezultuar mirë.

Sa jeni të kënaqur me angazhimin e policëve të cilët ndjekin kursin? Si e vlerësoni bashkëpunimin e ndërsjellë që keni?

Tog/Pontassuglia: Jam shumë i kënaqur me angazhimin dhe vullnetin e policëve të SHPK-së në këtë drejtim. Ne kemi bashkëpunim shumë të mirë, si me policët që e ndjekin kursin, po ashtu edhe me Qendrën për Siguri Publike, e cila i përkrah trajnimet që i bëjmë.

Në muajin janar do të përfundojë kursi të

cilin jemi duke e mbajtur, mirëpo kjo s'do të thotë se ne edhe në të ardhmen nuk do të kemi bashkëpunim me SHPK-në. Vullneti i mirë dhe serioziteti në punë, sjellin rezultate të mira në fund, prandaj dua të them që kjo e karakterizon edhe SHPK-në.

A keni për të shtuar diçka për fund?

Tog/Pontassuglia: Ju falënderoj për bashkëbisedën. Është vërtet kënaqësi fakti që përveç punës profesionale me njerëz të mirë, unë kam përfutur edhe një shoqëri shumë të mirë dhe vazhdoj të jem i rrethuar nga njerëz që kalojnë çaste të shkëlqyeshme.

*Intervistuar nga Njomza Krasniqi -
Zyra për informim e QKSPEZH-së*





Ndërtesa ku janë të vendosur zyrtarët rajonal të Mitrovicës

Kur do të kenë objektet e tyre?

REGJIONI I MITROVICËS NË PRITJE TË REALIZIMIT TË OBJEKTEVE POLICORE

Regjioni i Mitrovicës numëron mbi 930 pjesëtar të SHPK-ës, të sistemuar në 7 stacione policore, dhe në njësitë përcjellëse të Komandës regjionale të Policisë në Mitrovicë, të cilët ofrojnë shërbimet e tyre gjatë 24 orëve në ditë, për më tepër se 370.000 banorë, të të gjitha përkatësive etnike dhe religjioze.

JO të gjitha stacionet policore në regjionin e Mitrovicës, e kanë të zgjedhur çështjen e pronës, atë elementare kulmin mbi kokë! Në fakt

vetëm dy stacione policore kanë të zgjidhur këtë problem.

Regjioni i Mitrovicës, përbëhet prej 7 stacioneve policore; (stacioni jugor Mitrovicë, stacioni verior Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Leposaviq, Zubin Potok, dhe Zveqan), katër nënstacione; (Prelluzhë-Vushtrri, Syriganë-Skenderaj, Suhadoll-Mitrovicë veri dhe Frashër-Mitrovicë jug) dhe dy zyre policore pjesë të projektit "polic i fshatit"; Qabër-Zubin Potok, dhe një zyre policore në lagjen e

romëve në Mitrovicë jug.

Përveç dy objekteve të stacioneve policore, asaj në Skenderaj dhe në Leposaviq, të cilat tashmë kanë të zgjedhur çështjen e pronës dhe pasurisë policore, objektet e stacioneve tjera së bashku me komandën regjionale dhe njësitë e saj; trafiku regjional dhe ROSU, mbesin çështje për diskutim dhe kërkesë për aprovim të zgjidhjes institucionale të kësaj çështje.

Si qëndron gjendja aktuale me objektet policore?

Stacioni policor Vushtri, posedon kontratën për ndërrim të objektit të aprovuar me pëlqimin e KK Vushtri, procedura e së cilës ende nuk ka marrë formën e saj përfundimtare deri në pritje të vendimit përfundimtar të gjykatës kompetente dhe drejtorisë së kadastrave në Vushtri!

Stacioni policor jugor në Mitrovicë, i vendosur në ndërtesën e ish kinemasë së qytetit, pronë e kuvendit komunal të Mitrovicës!

Stacioni policor veri në Mitrovicë, i vendosur në ndërtesën e ish organizatës "Trepça commerce", dhe stacioni policor Zveqan, janë nën menaxhim të Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit (AKM)!

Stacioni policor Zubin Potok, i vendosur në një shtëpi private i huazuar me qira, i kushton buxhetit të SHPK-ës, hiq më pak se 1000 euro në muaj!

Komanda regjionale e policisë në Mitrovicë, e vendosur në qendër të qytetit, nën menaxhim të AKM-ës! Njësia e trafikut regjional, e vendosur në objektin e qendrës së regjistrimit në shfrytëzim të përkohshëm!

Njësia mbështetëse operative regjionale, e vendosur në ish kazerëm ushtarake, në shfrytëzim të përkohshëm nga kuvendi komunal në Mitrovicë.

Nënstationet policore të vendosura në pronat e kuvendeve komunale përkatëse, në shfrytëzim të përkohshëm, ashtu si edhe zyra policore në lagjen e romëve në

Mitrovicë, në shfrytëzim të përkohshëm me miratim të KK Mitrovicë!

Përpjekjet për zgjedhjen e këtyre problemeve?

Regjioni i Mitrovicës, ka pasur të ndara 500.000 euro, për investime kapitale për vitin kalendarik 2007, të cilat kanë qenë të planifikuara për ndërtimin e objektit policor të stacionit jugor në Mitrovicë, dhe për rinovimin e stacioneve policore, Vushtri, Leposaviq dhe Zveqan.

Për ndërtimin e stacionit jugor, kanë qenë të parapara 400.000 euro, ndërsa për rinovimin e stacioneve; Vushtri 20.000 e, Leposaviq 65.000 dhe atij në Zveqan me 15.000 euro.



Stacioni Policor Jugor-Mitrovicë


Stacioni Policor i Zubin Potokut

Për shkak të ndryshimit të strategjisë me qëllim që të ndërtohet objekti i Komandës regjionale në Mitrovicë, buxheti i planifikuar për ndërtimin e stacionit jugor Mitrovicë, dhe i rinovimit të stacioneve; Vushtrri dhe Leposaviq, gjithsej në vlerë prej 485.000 euro, është marrë.

A është zgjidhur problemi? Jo! Sepse lokacionet e parapara dhe të propozuara si të përshtatshme për ndërtimin e objektit të komandës regjionale ku do të vendoseshin edhe njësia e trafikut regjional dhe NjMO-sw, përkundër të gjitha përpjekjeve të bëra nuk ka hasur në aprovimin dhe miratimin e saj nga kuvendi komunal i Mitrovicës dhe agjencionet tjera. Arsyet siç thonë janë të shumta (Diskutabile? Pronë e AKM-ës? Pronë e kuvendit komunal?).

Si pasojë e mosrealizimit të këtij projekti, komanda regjionale është

dashur që t'iu kthej prapa buxhetin e paraparë për rinovim stacioneve Vushtrri dhe Leposaviq, të cilat projekte tashmë janë realizuar, ndërsa rinovimi i stacionit Zveqan, përkundër buxhetit të zotuar prej 15.000 e, ka mbetur i pa përfunduar nga ana e kontraktuesit.

Pjesa më e mirë e tërë kësaj ngjarje qëndron në faktin se buxheti i vitit 2007, në vlerë prej 400.000 euro, është autorizuar të bartet për vitin 2008, për investime kapitale në ndërtimin e objektit të komandës regjionale.

Premtimet për realizim gjatë vitit 2008?

Udhëheqësit e administratës të komandës regjionale në Mitrovicë, vitin e ri kalendarik 2008, e kanë filluar pa humbur kohë me kërkesat dhe propozimet e tyre për realizimin e ndërtimit të objekteve

policore, në radhë të parë komandës regjionale.

Kërkesa e drejtuar edhe përfaqësuesit special të sekretarit të përgjithshëm të kombeve të bashkuara në Kosovë, për të ndërtuar objektin e komandës regjionale në ish bazën e kazermës ushtarake mbetet në pritje të vendimit përfundimtar, ndërsa zyrtarët e administratës kanë intensifikuar takimet e tyre me krerët e pushtetit lokal për realizimin e projekteve të filluara për ndërtim të komandës regjionale dhe stacionit policor jugor në Mitrovicë.

Rezultatet e premtimeve të zotuarra për zgjidhje të këtij problemi mbeten të shihen në vazhdim, ndërkaq për stacionet policore, Zubin Potok, Zveqan dhe Veri në Mitrovicë, mbetet të kërkohej zgjidhje në projektet kapitale të viteve në vijim.

Nga Besim Hoti

Ndodh edhe kjo !!!

Si (nuk) duhet të veproni nëse hasni në mjete shpërthyese

Një person në rajonin e Gjilanit kishte raportuar në polici se afër një lumi ka vërejtur një mjet të dyshimtë të pa eksploduar. Menjëherë në vendin e ngjarjes kanë dalë njësitet policore të cilat vërejtën gjurmë që tregonin se mjeti ishte goditur me mjete të

forta. Më vonë në vendin e ngjarjes paraqitet edhe personi i dyshuar mashkull/K/Shqiptar i cili deklaroi se ishte ai që e kishte hedhur atë mjet pasi që nuk ka arritur ta shes nëpër hekurishte. Ende nuk dihen arsyet se çfarë ka dashur ai që të arrij me "goditjen" e këtij mjeti por me

siguri është kuptuar se ai është mjaft fatlum.

Një rast tjetër interesant që ka ndodhur poashtu në rajonin e Gjilanit ishte kur një qytetar gjilanas derisa po kryente disa punime rreth shtëpisë së tij në lagjen Kodra e Dëshmorëve, kishte vërejtur se disa fëmijë po mbanin në dorë një mjet shpërthyes (granatë dore) dhe po loznin me të. Ai e merr granatën e dorës nga fëmijët, e largon në një vend të sigurt dhe njofton policinë. Njësitet patrulluese sigurojnë vendin e ngjarjes deri sa aty të del njësi i KFOR-it për çminim dhe asgjëson në mënyrë të kontrolluar mjetin e dyshuar.

E tërë kjo tregon se me gjithë angazhimet e njësiteve të ndryshme policore, KFOR-it dhe medimeve të ndryshme, për vetëdijesimin e qytetarëve për rrezikun nga mjetet shpërthyese, ende ka shumë punë për t'u bërë.

Këto janë vetëm dy raste që kanë ndodhur gjatë muajit shkurt, e që ndoshta ka pasur edhe më shumë raste të raportuara në nivel të këtij rajoni apo në tërë Kosovën. Nëse kthehemi dhe shikojmë ngjarjet nga disa vite më herët, sidomos gjatë fazës së amnistisë së armëve, këto raste nuk janë edhe "aq tragjike", nëse krahasohen me "bartjen e minave anti-tank në bagazhin e veturës" për ti dorëzuar ato, ose rastet kur është dashur të evakuhon i tërë stafi i policisë së një stacioni policor, për arsye se një person me "xhepat e mbushur me granata" kishte ardhur t'i dorëzonte ato.




1



Zv. Komisar i SHPK-së, gjeneral nënkolonel Sheremet Ahmeti, është lau-ruar me çmimin ndërkombëtar "Ambasador i Paqes", që i është ndarë nga Federata Universale e Paqes. Me këtë rast Ahmeti ka pohuar se ky është një nder dhe kënaqësi për të dhe të gjithë pjesëtarët e SHPK-së. Udhëheqësi i Federatës Universale për Paqe, z. Yong Cheol Song, ka shprehur kënaqësinë e veçantë për ndarjen e çmimit ndërkombëtar "Ambasador i Paqes" për Zv. Komisar in e SHPK-së, të cilin e ka cilësuar si promovues të vlerave të paqes dhe stabilitetit në rajonin e Ballkanit.

2



Zv. Komisar i policisë Robert Locke dhe zëvendës shefi i OSBE-sw Marku Laamanen ia kanë dorëzuar SHPK-së doracakun e parimeve dhe procedurave. Këta doracakë të SHPK-së u shtypën me ndihmën e OSBE-së. "Kodi kryesor për stabilitetin e shoqërisë është sundimi i ligjit. Puna që ne kemi bërë bashkërisht është esen- ciale për ndërtimin dhe stabilitetin e një shoqërie"- theksoi z. Laamanen.

3



Në foto shihet fotografi i Re- vistës Mbrojtësi-Hakan Ugurlu, pas pranimit të një letër falënderimi nga Zv. Komisar i SHPK-së Ahmeti. Z. Ugurlu këtë mirënjohje e mori për kon- tributin e dhënë në përkrahjen e SHPK-së gjatë misionit të tij në Kosovë si staf i Njësitit të redaksisë të revistës zyrtare të Policisë në Kosovë.

4



Pas procesit mësimor, fëmijët shpeshherë janë të rrezikuar nga aksidentet në trafik. Në foto shihen oficerët e SHPK-së nga rajoni i Mitrovicës duke u përkujdesur për sigurinë e fëmijëve në komunikacion.

5



Më 29/01/2008 Njësia e Hetimeve Transkufitare ka kryer një operacion në Ferizaj me ç'rast janë arrestuar tre të dyshimtë (dy nga ta Shqiptar të Shqipërisë dhe një Shqiptar Kosovar) si dhe janë konfiskuar 17 copë revole si dhe 50 copë fishekë. Në vazhdimësi të këtij operacioni policia ka kryer një operacion bastisjeje në dy fshatra tjera dhe janë arrestuar dy të dyshuar (Kosovar shqiptar) si dhe janë konfiskuar 9 revole, 1 Kallashnikov, 1 pushkë gjuetie dhe 1740 copë fishek të kalibrit të ndryshëm. Policia ka konfiskuar edhe makinën e cila ka shërbyer si modifikues i revoleve të kalibrit të vogël.



Kështu i falënderohen pjesëtarëve të SHPK-së nxënësit e shkollës fillore "Ali Kelmendi" të Vushtrrisë.



revistambrojtesi@gmail.com ose mund
ti dorëzoni në Zyrën për Informim Publik në
Shtabin e Përgjithshëm të Policisë, zyra nr1.

Shkrimi më i mirë do të zgjidhet nga komisioni tre anëtarësh i zgjedhur nga njësiti i redaksisë dhe do të publikohet në numrin e ardhshëm.